



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

BORA HABILI

Bora Habili ushtron detyrën e Drejtores së Drejtorisë së Vlerësimit të Arritjeve dhe Performancës Arsimore pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, funksion të cilin e mban nga viti 2023 e në vijim.

Më herët, ajo ka drejtuar Sektorin e Administrimit të Provimeve (2022–2023), ku ka udhëhequr proceset e përgatitjes, administrimit dhe përpunimit të bazës materiale dhe të dhënave të provimeve kombëtare. Para këtij pozicioni, ka shërbyer si specialiste pranë Sektorit të Njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar (2021–2022). Znj. Habili është bashkëpunëtore e Qendrës së Shërbimeve Arsimore që prej vitit 2019.

Ajo ka punuar më parë si mësuese e matematikës në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, si edhe në pozicione profesionale që përfshijnë administrimin, verifikimin e të dhënave dhe analizën statistikore. Gjithashtu, ajo është angazhuar në mësimdhënie në arsimin e lartë, në fushën e statistikës.

Znj. Habili ka përfunduar studimet Master në Informatikë të Aplikuar – Menaxhim të të Dhënave, Master Shkencor në Mësimdhënien e Matematikës, si dhe Bachelor në Matematikë. Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

Përveç formimit universitar, Znj. Habili ka thelluar ekspertizën e saj në Data Science, programe statistikore aplikative, si dhe në zhvillimin e aftësive drejtuese përmes trajnimeve dhe programeve ndërkombëtare të lidhshme.